



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Komiteti për Komunitete
02.Nr.I
Deçan, dt. 14.01.2022

PROCESVERBAL

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete e mbajtur me 14.01.2022.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE.

Takimi u kryesua nga z. Shaban Pejqinović ku i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës që e ishin për këtë takim.

Themelimi i Komitetit për Komunitete dhe zgjedhja e kryesuesit të ri të këtij Komiteti.

Për kryesues të ri të këtij Komiteti u propozua Shkelzen Berisha nga komuniteti egjiptian, i cili nuk kishte konkurrentë gjatë votimit dhe me vota të lira ai u zgjodh Kryesues i Komitetit për Komuniteteve.

Më pas fjalën e mori kryesuesi i sapozgjedhur i këtij Komiteti Shkelzen Berisha, i cili falënderoi të gjithë të pranishmit për zgjedhjen e tij dhe aji premtoi se do të bëjë më të mirën për këtë Komitet.

Më pas fjalën e mori asambleistja e Kuvendit Komunal Albesa Cacaj, ku e përgëzoi për zgjedhjen e Kryesuesit dhe tha se kisha dashur që ky Komitet për Komunitete të funksionoj ashtu si duhet e të mos është formalitet zgjedhja e këtij kryesuesi dhe këtij Komiteti, dhe në fund tha që do të punojmë me vullnet të plotë dhe se të gjithë anëtarët e këtij Komiteti duhet të japim kontributin e duhur.

Më pas fjalën e mori Haxhi Thaqi nga OSBE-ja, i cili tha se jam i kënaqur që u konstitua ky Komitet dhe u zgjedhë kryesuesi i ri i këtij Komiteti, sepse ky Komitet ka vlerë të madhe sepse është zëri i Komuniteteve dhe tha që duhet të punojmë për mbrojtjen e të drejtave të Komuniteteve pakicë.

Në këtë takim u diskutua për Plani i Punës për Komitetin për Komunitete dhe u propozua që tu dërgohet të gjithë anëtarëve të Komitetit dhe që në mbledhjen e ardhshme të diskutohet rreth ti.

Kryesuesi i këtij takimit i falënderoi të pranishmit dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtësi:
Drin Balaj



Kryesuesi i mbledhjes
Shaban Pejqinović



Komiteti për Komunitete
02.Nr.II
Deçan, dt. 11.02.2022

PROCESVERBAL

Mbledhja e Dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete e mbajtur me 11.02.2022.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u.

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha ku i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës që e ishin për këtë takim.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raport nga ZLK-ja
3. Diskutim dhe aprovim i Planit të Veprimit të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
4. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së.

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinoviç raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve ku tha se në si zyre gjatë këtij muaji kemi pas dy raste të riadhesimit të cilët kanë kërkuar vërtetim që janë të riadhesuar mirëpo ata nuk kanë qenë të regjistruar në sistem dhe për këtë shkak nuk kemi muajt t'ju lëshojmë vërtetim.

III. Diskutim dhe aprovim i Planit të Veprimit të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

Gjatë diskutimit për Plan të Veprimit të Komitetit për Komunitete për vitin 2022 u propozua që vizita e vendbanimeve ku jetojnë komunitetet, e parapar për muajin tetor të përsëritet edhe në muajin gushtë dhe ftesa për drejtorin e bujqësisë e parapar për muajin shkurt të realizohet në njërin nga muajt pasues, pas këtyre propozimeve Plani i Veprimit të Komitetit për Komunitete për vitin 2022 u aprovua njëzëri.

IV. Të ndryshme.

Millanka Popoviç e mori fjalën ku i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe pyeti se pse nuk ka përfaqësues të komunitetit serb në këtë Komitet të Komuniteteve, ajo tha se si përfaqësues e komuniteti malazez s'po mund të përfaqësoj edhe komunitetin serb, ku dha arsyejet rreth angazhimit të saj dhe pa mundësisë për të përfaqësuar të dy komunitetet.

Gjithashtu kërkoj që të sigurohet një përkthyes i gjuhës serbisht-shqip sepse unë s'marr vesh shumë mirë shqip dhe e flas pak shqipen dhe po tutem se gjatë fjalimit tim, fjalët e mija po marrinë kaheje tjetër.

Kryesuesi i faleminderoj të gjithë të pranishmit dhe e mbylli mbledhjen.

Procesmbajtësi:
Drin Balaj



Kryesuesi i mbledhjes
Shkelzen Berisha



Komiteti për Komunitete
02.Nr.III
Deçan, dt. 11.03.2022

PROCESVERBAL

Mbledhja e Tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete e mbajtur me 11.03.2022.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u.

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha ku i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të dites që e ishin për këtë takim.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raport nga ZLK-ja
3. Raporti i drejtorit të bujqësisë
4. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së.

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinoviç raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve ku tha se në si zyre gjatë këtij muaji nuk kemi pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar apo raste të tjera që mund ti cekim. Qa vlen të ceket është se një familje nga komuniteti boshnjak ka përfituar një lopë nga drejtoria e bujqësisë në Deçan.

III. Raporti i drejtorit të bujqësisë

Drejtori i Bujqësisë Rifat Stojkaj tha se vitin që po e lejmë pas 381 familje kanë përfituar nga grandet për bujqësi si mjete pune për bujqësi apo ndihma të ndryshme, ndërsa këtë vit në konkursin për lopë që ishte ka konkurruar vetëm një person nga komuniteti boshnjak Ragip Koiq dhe ky ka përfituar një lopë qumështorë, tjerë konkurrues nga komuniteti nuk ka pasur, në këtë seri janë shpërndarë 22 lopë qumështorë, pritet që seria dytë të ketë 45 tjera që do vazhdohet me listën pasuse duke jau shpërndarë atyre që i plotësojnë kushtet. Drejtori për Bujqësi i ftoj të gjitha komunitetet që të aplikojnë çdo herë kur të ketë grande të ndryshme nga komuna.

IV. Të ndryshme.

Albesa Cacaj asambliste nga radhët e LDK-së propozoj që të thirret drejtori i arsimit dhe të diskutohet rreth çështjes së bursave.

Kryesuesi i faleminderoj të gjithë të pranishmit dhe e mbylli mbledhjen.

Procesmbajtësi:

Drin Balaj



Kryesuesi i mbledhjes
Shkelzen Berisha



Komiteti për Komunitete
02.Nr. IV
Deçan, dt. 15.04.2022

PROCESVERBAL

Mbledhja e Katërt e rregullt e Komitetit për Komunitete e mbajtur me 15.04.2022.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u.

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha ku i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të dites që e ishin për këtë takim.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raport nga ZLK-ja.
3. Raporti i drejtorit të arsimit.
4. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së.

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinoviç raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve ku tha se gjatë këtij muaji kemi pas disa palë që ju kanë drejtuar zyrës me disa kërkesa, gjatë këtij muaji kemi pas takim me Kryeministrin e Kosovës ku gjatë takimit me të na premtoj se do na përkrahë, po ashtu gjatë këtij muaji kemi pas takim me Ministrin për Kthim ku na është prezantuar programi për regjistrimin e personave të kthyer. Neve si zyre na është premtuar rruga për komunitetin boshnjak në fshatin Prapaqan ajo do të ndërtohet nga Komuna e Deçanit në bashkëpunim me Komunën e Pejës.

III. Raporti i drejtorit të arsimit

Drejtori i Arsimit kishte dërguar një përfaqësues dhe aji na njoftoj se Komuna e Deçanit ka 5000 nxënës nga ta 87 janë nga komunitetet nga këta 8 janë nga komuniteti boshnjak tjerët ju përkasin komuniteteve të tjera, nga komunitetet kemi vetëm një rast të braktisjes së shkollës, nxënësi është i moshës 15 vjeçare dhe e ka braktisur gjimnazin.

Komuniteti ka qene i gjithëpërfshirë në të gjitha shkollat pa dallim, dy shkollat të cilat kanë numrin më të madh të nxënësve nga komuniteti janë shkolla "Drita" në Gramaqel me 25 nxënës dhe "Rexhep Kadrijaj" në Restovic.

Sa i përket raportit rreth bursave, komuna nuk ka ndarë bursa vetëm Ministria e Arsimit ka ndarë bursa, ne to kanë qene të përfshira komunitetet në përgjithësi.

IV. Të ndryshme.

Kryesuesi i takimit Shkelzen Berisha propozoj që muajin tjetër të thirret Drejtori i Urbanizimit.

Përfaqësuesja e IOM shpreh mundësin e financimit të një projekti të përbashkët të komuniteteve në Komunën e Deçanit ku komuna duhet të participojë me 30% dhe pjesën tjetër IOM, ajo kërkoj nga përfaqësuesit e komuniteteve që të vinë me disa propozime apo ide për këtë projekt.

Millanka Popoviq përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe tha se ka një kërkes nga komuniteti serbo-malazez për realizimin e një vizite shko dhe shiqo ku ata dëshirojnë të vizitojnë pronat e tyre të cilat i kanë pa shitura në fshatrat Dashinoc, Maznik, Prapaqan, Ratish i Epërm, Ratish i Ulët dhe Lumardh, ajo tha se pas këtyre festave do të paraqes kërkesë me shkrim.

Procesmbajtësi:

Drin Balaj



Kryesuesi i mbledhjes
Shkelzen Berisha



Komiteti i Komuniteteve
01.Nr.VI
Deçan,dt.10.06.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e V-të rregullt të Komitetit të Komuniteteve, me dt.10.06.2022.

Në mbledhje merrnin pjesë: anëtarët e Komitetit të Komuniteteve, Shaban Pejçinoviç, UNMIK, OSBE.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Komitetit, z.Shkelzen Berisha.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporti i ZLK-së,
3. Të ndryshme.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet njëzëri pa vërejtje.

II.Raporti i ZLK-së.

Shaban Pejçinoviç-thot se si zyre kanë punuar me palë dhe ju kemi ndihmuar palëve nga komuniteti jo shumice ne kryerjen e punëve me procedurë administrative, kemi qenë takim pune në Troftë të Istogut, me dt.16.05.2022, gjatë kësaj kohe e kemi bërë kërkesën për riparim të shtëpisë së Xhavit Berisha, të cilit i kanë hy gjarpërinjtë në shtëpi dhe si rezultat i kësaj shtëpia është demoluar, poashtu njofton se kemi pasur një të kthyer pas 30 vite në migrim. Shabani njofton se kemi bërë vizitë në 7 fshatra dhe kërkesat e qytetarëve kanë qenë kryesisht për rregullim të infrastrukturës si:rrugë, rrymë, ujë, etj.

Albesa Cacacj- njofton se si Komitet kemi dalë në teren me dt.16 maj, ku i kemi parë për së afërmi nevojat primare të çdo fshati, siq janë:Pemishte - kanalizimi në dy rrugë, Gramaqel - rregullimi i rrugës dhe kërkesa për vendosjen e rrymës nëpër shtylla, Shaptej - kërkesa për kanalizim, Pozhar-kërkesat për Kanalizim, ndriçim, kanali për ujitje nuk pastrohet kurrë dhe shtyllat, Prapaqan-kërkesa për rregullim të rrugës, ndriçimi publik dhe kanalizimi, Baballoq-kërkesa për pastrimin e kanalit, Dubovik-problemi me shtylla.

Shaban Pejçinoviç- ka thënë se të vetmen kënaqësi komuniteti e ka me shërbimet që i ofrohen nga Ndërmarrja Higjiëna.

Komiteti njëzëri miratohet Rekomandimet për Kuvendin e komunës:

Komiteti i rekomandon Kuvendit që të përfshihen në planifikimin buxhetor edhe kërkesat e komunitetit pakicë siç janë:Asfaltimi i rrugëve, kanalizimi dhe rregullimi i ndriçimit publik, të identifikuara pas daljes në teren.

III.Të ndryshme:

Millanka Popoviç-pyet, a ka përgjigje rreth kërkesës së mëhershme për organizmin e vizitës “shko dhe shiqo” prandaj unë kërkoj të njoftohem se kurë do të bëhet kjo vizitë sepse edhe unë duhet të njoftoj për këtë personat e interesuar që dëshirojnë të bëjnë këtë vizitë ka thënë ajo, si dhe unë ka thënë ajo do të paraqes një ankesë të kryetari i komunës për arsy se në ZLK nuk ka Zyrtar për Komunitete dhe Kthim (për të cilin Shaban Pejçinoviç e ka njoftuar se janë krye procedurat e rekrutimit dhe Zyrtari për Komunitete dhe Kthim është pranuar në punë me konkurs dhe së shpejti do të del në punë pasi që i njëjti ka pasë disa probleme shëndetësore).

Elmedina Sadikaj- thot se gjatë vizitës që i kanë bërë komunitetit pakicë kanë konstatuar se edhe ata i kanë të njëjtat kërkesa dhe nevoja siç i ka edhe komuniteti shumicë këtu te ne.

Kryesuesi i komitetit, z.Shkelzen Berisha, njoftoj se dje e kemi pasë të caktuar një takim me Kryetarin e Komunës në ora 09:00, dhe ai kishte pasë edhe një takim tjetër në të njëjtën kohë dhe vetëm në korridor na pyeti për arsyen e takimit dhe kjo gjë nuk më pëlqej dhe mu duk jo e hieshme që nuk e ndau Kryetari i Komunës pak kohë në zyrë edhe për ne.

Kryesuesi i falënderoj të pranishmit dhe e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtëse, Dyke Lllolluni



Kryesuesi i Komitetit:
Shkelzen Berisha